

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-087/2014

Prishtinë
19 Tetor 2016

Në çështjen juridike të:

1. I.Sh.
2. A.Sh.
3. M.Sh.
4. S.Sh.
5. S.Sh.
6. K.Sh.
7. A.Sh.

Trudë
Prishtinë

Palët ankuese

Përfaqësues:
F.Sh.
Avokat
Rruga A. Ramadani 10
Prishtinë

kundër.

M.T.
Lebanë
Prishtinë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Anna Bendarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (më tutje: KKPK) nr KPPC/D/A/119/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA90152), të datës 7 shtator 2011 (më tutje: vendimi i KKPK-së), pas shqyrtimit të mbajtur më 19 Tetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. **Pranohet si e bazuar ankesa e paraqitur nga I.Sh. , A.Sh. , M.Sh., S.Sh. , S.Sh. , K.Sh. dhe A.Sh. .**
2. **Anulohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPPC/D/A/119/2001, të datës 7 shtator 2011, sa i përket kërkesës nr. KPA90152.**
3. **Hidhet poshtë kërkesa nr. KPA90152 e M..T., sepse kërkesa nuk është në juridiksion të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 14 mars 2007, paraqitësi i kërkesës M.T. (më tutje: pala përgjegjëse në ankesë) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar të drejtën e pronësisë dhe ri-posedimin mbi ngastrën nr. 41, zona kadastrale Nëntë Jugoviq, vendi i quajtur Plandishte, Komuna e Prishtinës, e identifikuar në fletën poseduese nr. 561 të datës 17 mars 2004 dhe e kategorizuar si arë e klasit 3, me sipërfaqe prej 0.80.15 ha (më tutje: prona e kërkuar). Ai kishte deklaruar se prona ishte e uzurpuar por në formularin e kërkesës kishte deklaruar se nuk e di kush e ka në posedim pronën.
2. Paraqitësi i kërkesës e mbështeti kërkesën e tij duke paraqitur në AKP *inter alia* këto dokumente:
 - Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës të datës 26 tetor 1994, P. nr. 316/94. Me këtë vendim është anuluar Kontrata e Blerjes e datës 18 nëntor 1963, OV.nr. 3501/63, e lidhur ndërmjet të ndjerës L.T. dhe Kooperativës Bujqësore ‘Devet Jugoviq’, prandaj pala përgjegjëse në ankesë dhe një person tjetër njiheshin si pronarë dhe duhet të kthehen në posedim te pronës së kërkuar;

- Fletën Poseduese nr. 561, të lëshuar më 17 mars 2004 nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi, Komuna e Prishtinës; sipas kësaj Flete Poseduese, pala përgjegjëse në ankesë dhe dy persona tjerë janë secili pronar i 1/3 të pronës së kërkuar.
3. Më 26 mars 2009 dhe 2 prill 2009, AKP-ja i verifikoi pozitivisht Aktgjykimin dhe Fletën Poseduese të cekura më lartë.
 4. Në 16 Janar 2009 dhe më 16 mars 2010, AKP-ja identifikoi pronën e kërkuar duke vendosur njoftim në pronën e kërkuar që tregon se prona është objekt i një kërkesë dhe se palët e interesuara mund t'i paraqesin përgjigjet e tyre brenda 30 ditësh. Prona u gjet e uzurpuar nga një person i panjohur. Përpjekjet për identifikimin e uzurpuesit ishin të pasuksesshme pasi që sipas spjegimeve të AKP-së disa banorë vendas nuk e dinin se kush e kishte uzurpuar pronën dhe disa të tjerë nuk dëshironin të tregonin për atë person. Më 17 mars 2010, AKP-ja konfirmoi se identifikimi i pronës së kërkuar ishte i saktë. Konfirmimi i identifikimit të pronës është bërë në bazë të koordinatave GPS dhe Ortofotove.
 5. Pasi që askush nuk reagoi ndaj njoftimit, kërkesa u trajtua si e pakontestuar.
Më 7 shtator 2011, KKPK-ja vendosi se pala përgjegjëse në ankesë kishte vërtetuar se ai është pronar i 1/3 të pronës së kërkuar, dhe urdhëroi që pala përgjegjëse në ankesë ka të drejtën e posedimit të pronës së kërkuar, dhe se çdo person që e ka uzurpuar pronën e kërkuar duhet ta lirojë atë ose përndryshe do të dëbohet. Në arsyetimin (paragrafi 12 i vendimit grupor), KKPK-ja vëren se pala përgjegjëse në ankesë, me provat e dorëzuara, e ka dëshmuar të drejtën e tij të pronësisë. Më 20 dhjetor 2013, palët ankuese paraqitën ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Së bashku me ankesën, ata dorëzuan *inter alia*:

- Vendimin e Komisionit Komunal për Kthimin e Tokës Prishtinë, të datës 13 qershor 1992 (nr. 462-49/91); sipas këtij vendimi *inter alia* është vendosur e drejta e pronësisë e I.A.M.S.K.A. Sh. mbi 1/5 pjesë e ngastrës kadasdtrale 41 me sipërfaqe të tërësishme prej 6h 60ari e 76 metra katrorë. Vendimi i formës së prerë me 30 Korrik 1992 obligon Kooperativen Bujqesore “Devet Jugović” që ta dorëzoi në posedim pronën tek pala ankuese e cila ishte konfiskuar nga kjo familje me 21 Shataor ;
- Aktvendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të datës 23 prill 2008, nr. SCC-08-0035; palët në atë procedurë ishin I.Sh. dhe të tjerët si paraqitës të kërkesës dhe Kooperativa Bujqësore Liria (ish- Devet Jugovic), pala përgjegjëse në ankesë dhe dy të tjerët si palë përgjegjëse në kërkesë; nga Aktvendimi mund të shihet nëse pala përgjegjëse në ankesë i është bashkuar kësaj procedure;

kërkesa e paraqitësve të kërkesës për verifikim të të drejtave tyre të pronësisë mbi pronën e kërkuar është hedhur poshtë si e papranueshme; kërkesa për rishikimin e këtij Aktvendimi është refuzuar me – po ashtu e paraqitur nga palët ankuese – vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të datës 9 dhjetor 2008, nr. SCC-08-0035.

6. Ankesa iu dorëzua palës përgjegjëse në ankesë më 29 prill 2014. Ai nuk ka paraqitur përgjigje ndaj ankesës.
7. Më 16 dhjetor 2014, Gjykata Supreme iu dërgoi palëve ankuese një Urdhër Gjykate. Nga palët ankuese u kërkua të qartësojnë se kush po vepron si palë ankuese në këtë lëndë, pasi që në letrën e ankesës palët ankuese ishin përshkruar si 'I.Sh. dhe të tjerët', dhe të shpjegojnë pse palët ankuese, pas njoftimit të kërkesës më 16 mars 2010, për herë të parë e kontaktuan AKP-në më 16 dhjetor 2010 dhe nuk morën pjesë në procedurën para AKP-së/KKPK-së.
8. Së bashku me përgjigjen e tyre, të datës 19 dhjetor 2014, përfaqësuesi i palëve ankuese dorëzoi autorizimet e të gjithë shtatë palëve ankuese dhe deklaroi se ata të gjithë janë palë në ankesë. Në pyetjen e dytë palët ankuese u përgjigjën si në vijim. Ata deklarojnë se për herë të parë kishin informatë për kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë para AKP-së/KKPK-së më 16 dhjetor 2013. Ata më tej deklarojnë se pala përgjegjëse në ankesë e dinte që nga viti 1992 se kush e posedonte pronën e kërkuar dhe se familja Shala është duke e shfrytëzuar pronën e kërkuar. Familja Sh. kishte kontakt me palën përgjegjëse në ankesë rreth kontestit. Ata më tej deklarojnë se në pronën e kërkuar punohet dy herë në vit, një herë kur mbillet dhe herën tjetër kur korret. Ata kurrë nuk kanë parë apo dëgjuar në arrë se ka ndonjë kërkesë në procedurë. Ata pretendojnë se pala përgjegjëse në ankesë është dashur ta informojë AKP-në se kush po e shfrytëzon këtë tokë, dhe se pala përgjegjëse në ankesë iu kishte dërguar atyre shumë ndërmjetës për ta lëshuar tokën.

Prendimet e palës ankuese

9. Palët ankuese në ankesën e tyre pretendojnë se vendimi i KKPK-së është i paligjshëm sepse përmban shkelje thelbësore dhe zbatim të gabuar të së drejtës procedurale dhe materiale, dhe është marrë duke u bazuar në vërtetim të mangët dhe të gabuar të gjendjes faktike. Ata konsiderojnë se pala përgjegjëse në ankesë ka arritur ta marrë vendimin e KKPK-së duke e mashtruar KKPK-në pasi që ai ka dështuar që të paraqet fakte relevante në KKPK. Palët ankuese pretendojnë se familja e tyre është pronar i

pronës së kërkuar dhe se pala përgjegjëse në ankesë e dinte se toka ishte në posedimin e familjes së tyre.

10. Palët ankuese më tej pretendojnë se familja e tyre e ka fituar pronësinë mbi pronën e kërkuar bazuar në vendimin 06 nr. 462-49/91, të lëshuar më 16 qershor 1992 nga Komisioni për Kthimin e Tokës të Kuvendit Komunal të Prishtinës. Familja nuk ka qenë në gjendje ta regjistrojë vendimin në Kadastër sepse ka pasur probleme kufitare me disa fqinjë. Por që nga atëherë, familja e ka kultivuar pronën e kërkuar dhe e ka poseduar të njëjtën pa pengesë.
11. Palët ankuese më tej pretendojnë se edhe ata kanë bërë përpjekje që ta regjistrojnë në kadastër pronën por nuk ka qenë e mundur të ekzekutohet vendimi i Komisionit për Kthimin e Tokës sepse Kadastrë i Komunës së Prishtinës *“nuk ka ekzekutuar asnjë vendim, qoftë vendim Gjykatë apo vendim të Komisionit për Kthimin e Tokës, e as ndonjë vendim që ndërlidhet me pronën shoqërore, për shkak të rezistencës nga udhëheqësia komunale (Bordi i Drejtorëve) që refuzoi t’i regjistronte këto vendime të lëshuara nga autoritetet komunale dhe gjyqësore para vitit 1999, duke pasur parasysh se ato janë lëshuar nga autoritetet e dhunshme Serbe dhe si të tilla ato nuk duhet të ekzekutohen”*. Sipas palëve ankuese ky refuzim ka zgjatur deri në vitin 2004 kur Zyra Ligjore e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) e ktheu lëndën në Kadastrin e Prishtinës pasi që ndërlidhet me pronën shoqërore, dhe sugjeruan se nuk ka pasur pengesa ligjore që i pengon ata ta ekzekutojnë vendimin e cekur. Pas kësaj, palët ankuese morën vesh se ata nuk mund ta ekzekutonin vendimin në fjalë pasi që prona e kërkuar, bazuar në Aktgjykimin C.nr.316/94, të marrë më 26 tetor 1994 nga Gjykata Komunale e Prishtinës, është regjistruar në emër të palës përgjegjëse në ankesë dhe dy të tjerëve. Me këtë Aktgjykim, është anuluar Kontrata e Blerjes OV.nr. 3501/63 e datës 18 nëntor 1963, e lidhur ndërmjet L.T. (babai i ndjerë i palës përgjegjëse në ankesë) dhe Kooperativës Bujqësore “Devet Jugović” nga Bardhoshi. Me aktgjykimin e njëjtë, prona e kërkuar (ngastra nr. 41) i është kthyer palës përgjegjëse në ankesë, V.J. dhe R.M. (si trashëgimtarë të L.T.).
12. Palët ankuese pretendojnë se ata e kontaktuan me palën përgjegjëse në ankesë me qëllim që të gjejnë një zgjidhje për problemin. Pasi që ata nuk ishin në gjendje të gjejnë zgjidhje, ata paraqitën padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme kundër palës përgjegjëse në ankesë dhe Kooperativës Bujqësore, duke kërkuar konfirmimin e të drejtës së tyre të pronësisë mbi pronën e kërkuar. Me Aktgjykimin e saj SCC-08-0035, të datës 23 prill 2008, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e hodhi poshtë padinë si të

papranueshme, duke e konsideruar çështjen si të gjykuar (res judicata) bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prishtinës C.no. 316/94 të datës 26 tetor 1994.

13. Palët ankuese pretendojnë se prona e kërkuar iu është dhënë atyre si kompensim bazuar në një marrëveshje të arritur me Kooperativën Bujqësore. Pala përgjegjëse në ankesë ka qenë në dijeni për këtë marrëveshje dhe e ka respektuar, dhe kurrë nuk ka thënë se ai kishte një Aktgjykim Gjykate në lidhje me pronën e kërkuar. Ata Për më tepër, palët ankuese deklarojnë se heshtja e palës përgjegjëse në ankesë ngrit dyshimin se Aktgjykimi Komunal i datës 26 tetor 1994 mund të jetë i falsifikuar.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

14. Pasi që palët ankuese nuk kanë qenë palë në shkallën e parë, Gjykata Supreme duhet të vlerësojë nëse ankesa e tyre është e pranueshme.
15. Duke konkluduar nga rrethanat e lartëcekura, Gjykata Supreme konsideron se vënja e njoftimit në kohën kur aktiviteti i fermerëve në toka bujqësore është i kufizuar, jashtë sezonit të aktivitetit bujqësorë dhe ekziston mundësia që për arsye të lokacionit të pronës së kërkuar që mund të jetë edhe në distancë nga vendbanimi kjo ka bërë që përpjekjet e AJP-së të konsiderohen si të pamjafrueshme dhe se **palët ankuese nuk janë njoftuar si duhet për kërkesën**
16. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (më tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50), për aq sa është relevante këtu *pala* mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të KKPK-së. Sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e kërkuar dhe çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë do të jetë palë në kërkesë dhe në procedurat e ndërlidhura, me kusht që personi i tillë ta informojë AKP-në për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën para AKP-së/KKPK-së brenda 30 ditëve nga njoftimi për kërkesën nga AKP-ja.

17. Mënyra e njoftimit të kërkesës në këtë procedurë është parashikuar me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria Ekzekutive duhet t'ia njoftojë kërkesën çdokujt përveç paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën, apo përndryshe bën përpjekje të arsyeshme që t'ia njoftojë kërkesën çdo personi që mund të ketë interes ligjor në pronën
18. Palët ankuese deklarojnë se familja e tyre e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar për një kohë të gjatë, që nga vitet e 90-ta. Rrjedhimisht, nuk ka ndonjë indikacion se ata kanë mundur ta huqin afishen dhe nuk kanë mundur të jenë në dijeni për kërkesën. Pretendimi i tyre në përgjigjen ndaj Urdhrit të Gjykatës se prona e kërkuar punohet vetëm dy herë në vit, një herë kur mbillet dhe herën tjetër kur korret(në të dya fotot e AKP-së në dosje nuk ka asgjë të kultivuar në pronën e kërkuar) dhe se ata kurrë nuk e kanë parë afishen e cila ishte vendosur në pronë
19. Gjykata konsideroi se pohimi i palës përgjegjëse në kërkesë se nuk e di faktin se kush e ka pronën e kërkuar në shfrytëzim është i pasinqert dhe i qëllimshëm për faktin se të dya palët para AKP-së kanë paqartur dokumente që dëshmojnë se në mes tyre ka ekzistuar një kontest pronësor rreth pronës së kërkuar qysh nga viti 1992. Për mëteper pala përgjegjëse nuk i ka kundërshtuar pretendimet e palës ankuese edhe pse ka pas mundësi të përgjigjet në ankesë.
20. Për keto arsye Gjykata me vendim procedural të datës 14 Korrik 2016 i njohu statusin e palës procedurale parashtruesve të ankesës me arsyetimin se pala përgjegjëse nuk i ka ofruar AKP-së informacionet e duhura për shfrytëzuesin aktual të pronës dhe AKP-ja nuk mund të pretendoi se palët ankuese janë njoftuar si duhet për kërkesën.
21. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, KKPK-ja ka kompetencë për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: (a) kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe (b) kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, ku pretenduesi i pronës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat të tilla pronësore.
22. Bazuar në dispozitat ligjore të nenit 194 të LCP-ës dhe nenin 182.2 (b) të Ligjit Nr. 03 / L-006 për Procedurën Kontestimore (tekstin e mëtejme: LPC), Gjykata e Supreme *ex officio* duhet të vlerëson nëse Komisioni kishte juridiksion për ta shqyrtuar kërkesën.

23. Në lidhje me çështjen, është e nevojshme të përcaktohet nëse pala përgjegjëse ka pas prova se ka qenë pronar i pronës së kërkuar, se e ka pas në shfrytëzim dhe se e ka humbur si pasojë e konfliktit. Pala përgjegjëse e ka ekzekutuar Aktgjykimin me regjistrim në kadster në vitin 2004 (shih raportin e verifikimit të datës 26 Mars 2009) kurse pala ankuese nuk e ka ekzekutuar fare vendimin e Organit administrativ për kthimin e pronës për pengesat që i janë bërë nga autoritetet sipas deklaramentit. Të dhënat kadastrale tregojnë se gjatë kohës së konfliktit prona ka qenë e regjistruar si shoqërore dhe vetëm në vitin 2004 është regjistruar në emër të palës përgjegjëse në regjistrat kadastrale të Kosovës kurse në regjistrat e zhvendur në Serbi pala përgjegjëse në ankesë del të jetë pronar. Neni 20 i Ligjit mbi Mardhënjet pronësore juridike (Gaz. Zyrtare e RSFJ Nr 6/80, 36/90) parasheh se *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”* - që nënkupton formën me shkrim vërtetimin e autoritetit dhe regjistrimin e pronës në regjistra publik. Edhe Ligji aktual nr. 03/l-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 parasheh se *“ 1. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri.* (anglisht .
24. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka dëshmuar se para konfliktit e kishte ekzekutuar Aktgjykimin dhe se ka pas të drejtë pronësore dhe posedim mbi pronën e kërkuar të cilën e ka humbur si pasojë e konfliktit. Pala përgjegjëse nuk i ka kundërshtuar pretendimet e palës ankuese se ajo ka qenë në posedim të pronës së kërkuar.
25. Nga informatat e dhëna nga AKP-ja në përgjigje të urdhrit të gjykatës, padyshim mund të konstatohet midis palëve eksiton një kontrast pronësore lidhur me pronën e kërkuar por që qartazi bie jashtë juridiksionit të KKPK-së.
26. Në bazë të mësipërmes dhe pavarësisht nga fakti nëse e drejta e pretenduar e palës përgjegjëse mbi bazën e aktgjyimit të cekur, mund të jetë ende e vlefshme, Gjykata Supreme konstaton se vendimi i KKPK-së përmban zbatim të gabuar të dispozitave ligjore procedurale në fuqi dhe se çështja bie jashtë juridiksionit të KKPK-së për arsye se posedimi nuk është humbur si pasojë e konfliktit apo e rethanave që lidhen me të.
27. Duke pas parasysh të mësipërmen, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

28.Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit,

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it